



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 02.12.2019 ora 13.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të kandidatëve për vendin vakant për Inspektor të Lartë të Drejtësisë : Artur Malaj, Joana Asimi Sorraj, Klodian Rado, Lindita Troja, Marsida Xhaferllari dhe Sokol Stojani

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit. Njoftohet se për një arsye shëndetësore familjare të papritur e ka të pamundur të jetë sot në mbledhje anëtarja e Këshillit Arta Marku

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të kandidatëve për vendin vakant për Inspektor të Lartë të Drejtësisë : Artur Malaj, Joana Asimi Sorraj, Klodian Rado, Lindita Troja, Marsida Xhaferllari dhe Sokol Stojani

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e gjetjeve për rastet e kandidatëve që janë kandiduar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon mbledhjen se kemi për të shqyrtuar tre raste si ai z. Artur Malaj, kandidimi i tij ka një të veçantë sepse ishte lejuar kandidimi nga KED dhe e kemi bërë prapë një relacion për ta riparë edhe një herë situatën, është rasti i znj.Xhaferllari e cila ka dërguar një kërkesë për heqje dorë dhe ai z. Rado gjithashtu, pastaj kandidatët e tjerë për të cilët do të shqyrtojmë gjetjet më në themel. Sugjeroj të fillojmë me rastin e parë, me z.Artur Malaj.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj.

Margarita Buhali, parashtron relatimin për kandidatin Artur Malaj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Ardian Dvorani shpjegon se vendimi i zbardhur nuk ka ardhur po gjithsesi ka ardhur shkresa nga Komisioni i Posaçëm i Apelit, e cila u relatua. Shkresa përmban dispozitivin e vendimit, i cili nuk është zbardhur akoma.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se Kam vetëm për të diskutuar edhe një herë atë që them se do të na ndodhi edhe herë të tjera i njëjti problem dhe

do të bjerë reputacioni të themi apo ideja që ky Këshill kalon dhe propozon individë të cilët se kanë përfunduar tërësisht procesin e vetting-ut.

Në asnjë moment nuk kam menduar që ka qenë qëllimi i këtij Këshilli por rikthej në vëmendje faktin që ngjarje të tilla, siç ndodhi edhe rasti i z. Muçi apo edhe ky rast, nëse do ketë kandidat e pavarësisht problematikave që mund të kenë, mund të na ndodhin përsëri nëse ne do të vijojmë me këtë mënyrë. Nuk është në dorën tonë, jam e sigurt që nuk varet prej nesh se ne mund të kemi një vlerësim tërësisht tjetër për secilin prej këtyre individëve, nëse do të duhej apo nuk do të duhej ta kalonte procesin e vettingut, Nuk është në dorën tonë, por e vërteta është që do të duhet ndoshta z. Kryetar, nëse keni gjyqtar apo prokuror të cilët janë në fazat e këtyre verifikimeve të kërkojmë që të paktën të jenë në listën prioritare sepse edhe kjo është një kërkesë që organet e sistemit të zbatimit të reformës në drejtësi të funksionojnë të gjitha së bashku si një e tërë për ta çuar reformën përpara.

Ndoshta ky është rasti kur ne i kemi bërë këto shkresa dhe do të ishte mirë që në vendimmarrjet tona, në pjesën përshkuese, edhe ta shënonit këtë gjë në një farë mënyre. Ne nuk kemi mënyrë tjetër, vendimet e Këshillit nuk kanë mënyrë tjetër për t'ju paraqitur publikut përveçse me veprimtarinë që ka kryer në pjesët arsyetuese të vendimeve, përse i përket kriterëve të verifikimit apo jo dhe për të treguar që ka bërë maksimumin apo se nuk ka bërë maksimumin për ta shtruar këtë çështje, për të parë në mënyrë që të mos çenohet ajo që është besimi i publikut tek Këshilli dhe tek reforma sigurisht. Nga ana tjetër ne na duhen më shumë gjyqtar profesionalist dhe na duhen magjistrat në këto kandidime.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashton se më vjen keq që do ti rikthehem edhe njëherë bisedës së muajit Mars sepse çështja u diskutua shumë gjërë edhe gjatë kur u ndërtuan aktet nënligjore nga Këshilli. Unë kështu do ta shikoja, nuk do ta shikoja pjesë apo difekt të theksuar të legjislacionit se sa mungesa e vullnetit të Këshillit për ta mbyllur një herë e mirë me një vendim që, çdokush që ka një vendim të formës së prerë, do të konsiderohet i suksesshëm për të kaluar në fazën tjetër. Sepse nëse e kujtojmë të gjithë, në ato mbledhje është diskutuar shpejtësia për të arritur një Inspektor të Lartë Drejtësie të emëruar shpejt dhe gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të emëruar shpejt. Ne as shpejtësi nuk na solli ajo vendimmarrje, përveçse na solli problematikë. Me të vërtetë një kandidat i lejuar u emërua, u ndalua rrugës dhe një kandidat tjetër i lejuar shpyqyr që u kap ky Këshill me vendimmarrje që po riparohet. Kështu që unë do ti rikthehesha edhe një herë në qoftë se Këshilli ka vëmendje për ta riparuar atë vendim, vendimi nr. 4 më duket se është, kandidatët të gjithë duhet ta kenë kaluar me sukses dhe sukses do të thotë me vendim të formës së prerë, për mendimin e institucionit që unë përfaqësoj. Sukses nuk do të thotë gjysëm-sukses. Do të thotë sukses i

plotë dhe i mbyllur me dosje të arshivuar. Megjithatë në këto kushte ku është, Këshilli i bie të revokojë vendimin e marrë por që, meqenëse nuk jam organ emërtese që të pranoj kandidat për emërim, mund të flas dhe një fjalë më shumë, revokimin e aktit të parë dhe shprehjen sipas vendimmarrjes së Këshillit për çfarë do të bëjmë me këtë kandidat, për lejimin ose jo të mëtejshëm të tij në fazën tjetër.

Anëtarët e Këshillit, përtej rastit konkret dhe procedurës së relatimit të tij, shprehën qëndrimin në parim që për magjistratët e kandiduar për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë vendosja e kriterit lejuar të kandidimit vetëm kur kanë kaluar procesin e vetingut me vendim të formës së prerë duhet të bëhet në mënyrë të shprehur vetëm me ligj, sikurse është e parashikuara në ndonjë rast tjetër kandidimi për organet e drejtësisë. Ndërsa për kandidaturar e shqyrtuara gjatë vitit 2019, Këshilli ka komunikuar shkresërisht me organet e rivlerësimi kalimtar duke kërkuar shqyrtimin me prioritet dhe shpjeguesi të kandidatëve që kanë qenë në procedurë verifikimi nga ky Këshill. Këto përfundime duhet të gjenë vend edhe në vendimet e Këshillit për shqyrtimin e kandidaturave në mbledhjen e sotme.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari.

Margaria Buhali, parashtron relatimin për kandidatën Marsida Xhaferllari për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se vullneti i shprehur nga kandidatja Marsida Xhaferllari për tërheqjen nga ky kandidim është i qartë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Klodian Rado.

Margaria Buhali, parashtron relatimin për kandidatit Klodian Rado për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë relatimit saktësohet se sipas shkresës që është protokolluar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me numër 789 datë 19.11.2019 është tërhequr nga kandidimi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese 7 dhe me shkresën nr. 790 datë 19.11.2019, plotësuar nga vetë kandidati në datën 18.11.2019, është tërhequr nga kandidimi për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se vullneti i shprehur nga kandidati Klodian Rado për tërheqjen nga ky kandidim është i qartë. Duhet të sigurohemi që gjithsesi kandidati ti jetë dërguar kopja e këtij relacioni e korrigjuar me të dhënat që rezultuan nga ky relacion.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Sokol Stojani.

Margarita Buhali, parashtron relacionin për kandidatit Sokol Stojani për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se kemi dhënë një koment për të bërë z. Kryetar. Është komenti ynë i përgjithshëm edhe këto dosje. Megjithatë numri ishte më i vogël, nuk na kanë ardhur siç i kemi kërkuar, pra me një listim të materialeve që na janë dërguar paraprakisht për ti parë dhe për ti verifikuar. Na kanë ardhur në datën 22 nëntor dhe për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore ka qenë e pamundur që grupi i punës në institucion të ketë studiuar të plotë dosjen. Gjithsesi nuk duam që të pengojmë procesin. Por dua që ta vë në dukje faktin se në kushtet kur nuk ka ndonjë punë shumë të madhe dhe shumë voluminoze do të ishte korrekte që lista e dokumentave të cilat na dërgohen të jetë bashkëlidhur materialet.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Lindita Troja.

Margarita Buhali, parashtron relacionin për kandidatës Lindita Troja për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe në fillim evidenton se në relacion, në faqen 8, në fillim të faqes, gabimisht është referuar neni 147/d duke u shkruajtur 1147/d, dy herë, edhe tek paragrafi i parë edhe në paragrafi. Ndërsa në lidhje me procedurën e ndjekur në verifikimin e kandidaturës, edhe për këtë rast kandidimi janë të njëjtat komente si në rastin e mëparshëm.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Joana Asimi Sorraj.

Margarita Buhali parashtron relatimin për kandidates Joana Asimi Sorraj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani menjëherë pas relatimit, merr fjalën dhe shpjegon se, meqenëse duket që nuk përmendet në relacion dhe ndoshta duhet këtu e në vendim, kujtoj që ka edhe një shkresë të dërguar nga KPK-ja që na informon se sapo kanë marrë dijeni për shpalljen e listës, në kushtet kur kandidatja indirekt kishte të bënte me procedurat e rivlerësimit të z. Fatri Islamaj, sipas procedurave të tyre të brendshme kanë marrë masat për ta larguar nga çdo lloj aksesit apo procedure të brendshme që ata kanë me rastin e z. Fatri. KPK na e ka dërguar kryesisht këtë shkresë për të evidentuar që ta shmangin nga konflikti i interesit

Fatri Islamaj shtron pyetjen se çfarë pune ka bërë kjo kandidatë?

Ardian Dvorani përgjigjet se kandidatja është këshilltare në KPK.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe deklaron se unë tani po vij në dijeni për këtë fakt. Pra, për sa i përket personit tim si anëtar i Këshillit, unë këtu tani po e marr vesh.

Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se kjo është e vërtetë. Nuk ka problem por duhet shtuar në vendim edhe ky moment, të cilin KPK na e ka bërë me dije kryesisht me këtë shkresë 2-3 ditë pas shpalljes së listës së kandidatëve. Nga shkresa na njoftojnë se sapo kanë ardhur në dijeni për kandidaturat menjëherë kemi marrë masat që të mos ketë të bëjë fare me rivlerësimin e z. Fatri. Shkresa duhet të ndodhet në dosje e kandidates.

Margarita Buhali shqyrton dosjen dhe lexon përmbajtjen e shkresës së datës 25.09.2019 të KPK: *Duke u shprehur përgëzimet tona për arritjet e deritanishme në punë...., KED-ja është organ që bën vlerësimin renditjen... në këto kushte menjëherë pasi jemi vënë në dijeni për këtë fakt edhe pse nuk është pjesë e procesit të vendimmarrjes të trupës gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit marrën masa për të ndërprerë aksesin e znj. Asimi në dosjet e subjektit Fatri Islamaj sapo kemi ardhur në dijeni të kandidimit.*

Anëtarët e Këshillit shprehin qëndrimin se asnjëri nga ne këtu nuk e di se çfarë këshilltarësh kemi patur për procesin e rivlerësimit. Edhe pse nuk është ngritur ndonjë lloj konflikti i interesit. Reagimi i KPK është shumë i drejtë sepse ka vënë Këshillin në dijeni për të qenë më komode në shqyrtimin e kandidaturës.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se kam një pyetje në lidhje me pjesën që ka qenë asistent pedagoge në periudhën janar 2004 shtator 2005 pranë Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Është me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme?

Margarita Buhali përgjigjet se e ka të pasqyruar në librezën e punës. Vjetërsia i është hedhur e gjitha aty dhe duke qenë se i është hedhur në librezën e punës ne e kemi pasqyruar siç është. E ka sjellë librezën në formën e kërkuar.

Erinda Ballanca merr fjalën, diskuton dhe shtron pyetjen se ju i keni kërkuar mendimin në lidhje me periudhën në të cilën ajo ka qenë në listë pritje. Ajo mund të përbëjë eksperiencë pune. Por a është kjo nga ato lloj periudhash e cila do të konsiderohet e tillë për të përmbushur kushtin e nenit 147/d që thotë “jurist i spikatur”. Sepse unë nuk shoh asnjë spikatje, në nivel specialisti ka qenë gjithmonë. Spikatja më e madhe është që është bërë këshilltare e KPK-së. Kushtetuta parashikon se duhet të jetë nga rradhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë. Ndërmjet parashikimit të Kushtetutës dhe të ligjit, në gjykimin tim Kushtetuta ka prioritet dhe për sa kohë Kushtetuta thotë “jurist i spikatur”, e kuptoj që mund të jetë vjetërsi pune por a është vjetërsi pune për këtë qëllim? Në këtë proces nuk i kemi hyrë vjetërsisë në punë për secilin prej personave, aq më tepër në rastin e Inspektorit, sipas rolit dhe rëndësisë së pozicionit së tij, siç i kemi hyrë në rastin e Gjykatës Kushtetuese. Por në rastin konkret thuhet jurist i spikatur, jemi në vit për vit dhe nga të tëra nivelet, i vetmi pozicion i spikatur është ka qenë këshilltare ligjore pranë KPK-së. Të gjitha të tjerat janë si specialiste. Edhe ju me shumë të drejtë e keni pyetur se si e vlerësoni ju këtë vetëm për efekt vjetërsie apo edhe për efekt të kushtit të juristit të spikatur ?

Anëtarët e Këshillit sqarojnë se kjo pyetje me të drejtë shtrohet por ka lidhje me interpretimin e ligjit. Por dhënia e përgjigjes është e barabartë me mbajtjen e qëndrimit dhe kjo lidhet me disponimin përfundimtar, me motivin e vendimmarrjes për dhënien e vendimit. Prandaj sigurisht që do të diskutohet dhe vlerësohet në atë moment ajo që parashikon Kushtetuta dhe ajo që parashikon ligji. Këshilli do ti interpretojë dhe zbatojë ato.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shtron pyetjen se për sa vite ka qenë pedagoge?

Margaria Buhali përgjigjet se që nga janari 2004 ka qenë pedagoge, dy vjet janë kohë e plotë dhe 6 vite janë kohë e pjesshme.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se më shumë për të trajtuar atë që citoi relatorja. Unë e kam studiuar materialin në Presidencë, relacionin që i përket kësaj kandidateje, më bëri përshtypje tendenca e saj për ta mbrojtur plotësimin e kohës së kandidimit nëpërmjet vërtetimit që kishte marrë së fundmi nga institucioni i Presidentit dhe këtë e krahasova me shkresat që ky Këshill i kishte dërguar Departamentit të Administratës Publike, Bashkisë Tiranës dhe KPK-së, për periudhën që ka qenë aty. Këtu më lind pyetja se përse nuk u pyet edhe Presidenti i Republikës në lidhje me vjetërsinë e kësaj apo me ndonjë masë disiplinore etj.. Prandaj vlerësuam që ta përcillnim të plotë praktikën, edhe në sensin e plotësimit të kushteve, për ta thënë drejtpërdrejt. Për arsye se askush nuk i mohon dot të drejtën një nëpunësi civil që, pasi ristrukturohet vendi i punës, si dhe ka ndodhur, të kalojë në

listë pritje, siç dhe ka ndodhur, dhe të paguhet për 12 muaj siç dhe ka ndodhur dhe pas përfundimit të kësaj periudhe, nëse nuk ka një vend për tu riaktivizuar në shërbim civil, ndërpritet pagesa. Me këta akte që kemi dërguar ne ndërprerjen e pagesës. Tashti është në vlerësim dhe Këshilli duhet ta bëjë këtë, mendoj unë, në qoftë se kjo është një përvojë pune në profesion, pra një përvojë e vazhduar. Nëse ky kandidat ka punuar për një vit apo është trajtuar financiarisht, duke u trajtuar ligjërish si vjetërsi pune për shkak të pensionit apo të drejtave të tjera që i takojnë për shkak të ligjit të nëpunësit civil. Por për shkak të atij ligji dhe jo të këtij se këtu kërkohet 15 vjet përvojë pune. Këtu përvoja e punës është e barazvlershme me këto? Kjo do të ngelet në vlerësimin e Këshillit dhe ky ka qenë qëllimi kryesor, për të dhënë një tablo më të plotë të akteve që i janë bashkëlidhur kësaj shkresë. Në të gjitha institucionet e tjera u drejtua me shkresë, Këshilli tek ne nuk erdhi, sepse për aty po bëhet i gjithë diskutimi ndërmjet kandidatit dhe Këshillit. Kjo është pjesa e parë.

Kam dy sugjerime, në vlerësim të Këshillit do ngelen sërish. Unë mendoj që sa i takon kushtit jurist të spikatur me 15 vjet përvojë pune në profesion është një çështje që Këshilli do ta marrë vëmendje dhe unë mendoj se ka dokumenta, jo për këtë kandidate, por për të gjithë. Për atë kandidaten që vjen nga Bashkia e Tiranës apo këtë kandidate nuk më kujtohet kush. Tjetri pastaj është magistrat, është tjetër gjë. Nëse janë pozicione që shfaqin spikatshmëri, janë të atij niveli që e përmbushin kushtin që dikton Kushtetuta. Por ajo që ngelet e papërmbushur në veprimtarinë e Këshillit është kushti që dikton neni 199 të ligjit nr.115/2016. Do të kërkoja vëmendjen e relatorit sepse është e rëndësishme. Në nenin 199 pika 1, ne e kemi përmendur edhe herë tjetër, pika 1 gërma “ë” parashikon që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës dhe kjo është në kohën e tashme, nuk është nga koha e shkuar apo nuk është përpara 90-ës. Është përmbushur ky verifikim, ky hetim i Këshillit, sepse bëhet fjalë për ata që janë agjent të sotëm? Unë pashë relacionet dhe nuk më rezultoi asnjë informacion i shkëmbyer në këtë drejtim me SHISH dhe AISM të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nuk e pashë të arsyetuar përmbushjen e kësaj pike konkrete.

Ardian Dvorani përgjigjet dhe sqaron se për të gjithë kandidatët dhe për këtë rast kërkimin e informacionit dhe marrjen e përgjigjete Këshilli e bën nëpërmjet DSIK-së. Në dosje nuk ka kërkesa për informacion dhe përgjigje direkte me SHISH dhe AISM. Këto organe ligjzbatuese nuk pranojnë të kontaktojnë direkt me Këshillin. Edhe për këtë kusht kandidimi i është kërkuar DSIK-së informacioni për të gjithë kandidatët. DSIK-ja është përgjigjur për të gjitha elementet, edhe për ato që përfshin neni 199 pika 1 shkronja “ë” e ligjit nr.115/2016. Përgjigja është se nuk ka të dhëna që janë të tillë. Përgjigjet nuk janë sjellë

konfidenciale, janë aty dhe kanë ardhur edhe për të pesë kandidatët. Në përgjigjet e saj, DSIK i është referuar pikës 89 të aktit nënligjor normativ Vendimi nr. 4/2019 të KED dhe janë përgjigjur duke referuar konkretisht shkronjën “a” pra që ka apo jo lidhje ose kontakte të papërshtatshme, si edhe shkronjës “c” nëse janë është bashkëpunëtor, agjentë të shërbimit informativ i shtetit.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe, pas përgjigjes sqaruese nga Këshilli, shprehet se gjithsesi unë vlerësoj që këtë informacion nuk mund ta japë DSIK sepse DSIK nuk ka të rekrutuar asnjë njeri aty. Rekrutimet i bën shërbimi, dy shërbimet, që janë organet kushtetuese dhe nuk monitorohen nga DSIK-ja që është organ në varësi të Kryeministrit, ky është qëndrimi im. Kështu që unë do shprehja kërkesën që Këshilli ti drejtohej SHISH dhe AISM-së së Ministrisë së Mbrojtjes nëse këta kandidatë janë ose jo, siç e ka ligji, agjent, informator të shërbimeve sekrete. Nëse janë të skualifikohen nga gara se është kusht. Nuk e shikoj si informacion të dhënë në mënyrë të plotë, ashtu si e lexoj unë. Pastaj është në vlerësim të Këshillit.

Ardian Dvorani përgjigjet dhe sqaron edhe njëherë se për shkak të natyrës së komunikimit që kemi patur në krye të herës, e jo në këtë rast vetëm, që kur kemi filluar procesin, është mbyllur kjo lloj përpjekje e jona. Shkurtimisht sqarojmë se këto agjensi kanë qëndrimin që nuk komunikojmë drejtpërdrejt me KED, nëpërmjet DSIK-së do t’ju a përcjellim informacionin. Kaq mund të thuhet në mënyrë të përmbledhur. Pas kësaj KED ka bërë atë procedurë, si në të gjitha rastet e tjera, nëpërmjet tyre DSIK. Nuk kemi mënyrë tjetër.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe, pas përgjigjes sqaruese nga Këshilli, shprehet se unë e kam shprehur edhe në mbledhje të tjera, për kandidatët e tjerë të lejuar, jo për këtë, për të gjitha rastet këtë kërkesë e kam pasur gjithmonë. Është një kusht që e dikton ligji. Pse të mos merrni informacionin e plotë. Jo mor vlla nuk është informator, nuk është agjent. Le ta thotë edhe DSIK-ja këtë. Por nga informacionet që merren nga shërbimet jo nga vetja, nga ato që ka në sirtarët e vet, sepse nuk i ka dhe nuk tregohen informatorët përveçse nga njeriu që e ka rekrutuar. Këtë duhet ta tregojnë sipas ligjit. E ka për sekret, tia dërgojë kryetarit nëse e ka.

Ardian Dvorani ndërhyt dhe sqaron se Këshilli ka kërkuar DSIK-së që nëpërmjet tyre të merren dhe përcillen informacionet nga agjencitë ligjzbatuese. Tani nuk mund të më në detaje. Komunikimi, i cili ka qenë i klasifikuar, thotë do t’ju a japim nëpërmjet DSIK-së dhe prezumohet që e kemi marrë nëpërmjet DSIK-së. Nuk mund t’ju them më tepër. Shërbimet nuk komunikojnë me Këshillin dhe, për të kujtuar, i kemi bërë atyre shkresa direkte që kur kishim kandidaturat më përpara, për të cilat nuk merrnim një përgjigje. Kemi

komunikim, që nuk ka lidhje me asnjë kandidat, sipas të cilit vijnë në dijeni se përgjigje direkte në KED nuk është e mundur. Pastaj kemi kërkuar duke i përsëritur kërkesat për të gjitha vakancat DSIK-së që të na japë ndihmë administrative për të kërkuar informacionin nëpërmjet tyre, ashtu si e kërkonin organet ligjzbatuese, e të na jepnin përgjigje. Dhe i kemi marrë përgjigjet si në të gjitha kandidaturat e tjera më përpara. Të njëjtën gjë kemi bërë tani. Tani ne nuk mund ta zgjidhim këtë problem ndryshe, përveçse në këtë mënyrë.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe, pas përgjigjes sqaruese nga Këshilli, shprehet se për natyrën e punës së shërbimeve unë nuk jam specialist i tyre. Por të paktën me ç'këshillohem me kolegë që kanë qënë drejtues të atyre shërbimeve, shërbimet tentojnë të rekrutojnë njerëz agjent, informator që bëjnë dhe punojnë në institucione shtetërore. Dhe kjo është një metodë e punës së tyre prej së cilës marrin informacion në mënyrë të vazhduar edhe i ruajnë informatorët. Por nuk ka sens që informatorët që ky ka apo agjentët që ky ka t'ja zbulojë një autoriteti politik që ka në varësi DSIK-në dhe nuk mundet. nuk shkon. Prandaj them që ky informacion ose vjen drejtpërdrejt ose jo, sepse nga kanali tjetër nuk besoj se do të vijë ndonjëherë. Prandaj unë e shoh të papërbushur si kërkesë të ligjit, meqë është e shkruajtur në ligj. A duhet rregulluar ligji? Është një hall tjetër, por sot është në fuqi.

Ardian Dvorani ndërhyr dhe sqaron se në këtë rast kemi proceduar njësoj si për të tjerët sepse nuk kishim rrugë tjetër për të marrë informacionin. Nuk duhet ti kthehemi një historie diksutimi të para 6 muajve. E kemi mbaruar dhe e kemi ezauruar këtë përpjekje.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës, njofton që nëse pas vendimmarrjes për lejimin apo ndalimin e kandidatëve të relatuar do të kemi 5 kandidatë të lejuar në mbledhjen e ardhshme do të zhvillohen intervistat me këta kandidatë, deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 14.37

Sekretare

Kryetar

Dorina Dulaj

Ardian Dvorani

Redjona Myrtja